



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:127496

Datë: 15.01.2024

Numri i dokumentit: 05190741

PML.nr.05/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës në çështjen penale ndaj të pandehurve: A. P., nga fshati ..., Komuna e M., dhe F. C., A. M. dhe G. I. nga P., etj., për shkak të veprës penale “*Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal*” të sanksionuar nga neni 277 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), lidhur me veprën penale “*Veprimet përgatiore për veprën penale vrasje e rëndë*” nga neni 173 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.8 lidhur me nën-paragrafin 1.13 të KPRK-së, veprën penale “*Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*” nga neni 356 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, veprën penale “*Detyrimi*” nga neni 328 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe ndaj të pandehurit A. P. edhe për veprën penale “*Deklarimi i rremë*” nga neni 384 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve: A. P., avokati Agron Curri, të pandehurit F. C. avokate Ardiana Azemi, të pandehurit A. M., avokati Mentor Neziri dhe mbrojtëses së të pandehurit G. I. avokate Teuta Zhinipotoku, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PS nr.6/2023 të datës 17.11.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.S.nr.236/2023 të datës 06.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve A. P., F. C., A. M. dhe G. I., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PS.nr.6/2023 të datës 17.11.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.S.nr.236/2023 të datës 06.12.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, me aktvendimin PS nr.6/2023 të datës 17.11.2023, ndaj të pandehurve: A. P., F. C., A. M. dhe G. I. etj., për shkak të veprës penale “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal” të sanksionuar nga neni 277 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), lidhur me veprën penale “Veprimet përgatiore për veprën penale vrasje e rëndë” nga neni 173 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.8 lidhur me nën-paragrafin 1.13 të KPRK-së, veprën penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” nga neni 356 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, veprën penale “Detyrimi” nga neni 328 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe ndaj të pandehurit A. P., edhe për shkak të veprës penale “Deklarimi i rremë” nga neni 384 paragrafi 1 i KPRK-së, iu ka vazhduar masën e paraburgimit, të pandehurin A. P., prej datës 17.11.2023 deri më 17.01.2024, të pandehurve F. C. e A. M. nga data 19.11.2023 deri më 19.01.2024 dhe të pandehurit G. I., nga data 20.11.2023 deri më 20.01.2024. Të pandehurve masa e paraburgimit u është vazhduar konform dispozitës së nenit 190 lidhur me nenin 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., e 1.2 pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3., të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN1.S.nr.236/2023 të datës 06.12.2023, i ka refuzuar si të pabazuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve A. P., F. C., A. M., dhe G. I. etj., dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit A. P., avokati Agron Curri, nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 të KPP-së, shkeljeve tjera të dispozitave të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimin gjyqësor për vazhdimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t`a aprovoj në tersi si të bazuar kërkesën e mbrojtëses së të pandehurit të parashtruar kundër aktvendimeve të atakuara , të ndryshohen aktvendimet e atakuara ashtu që i mbrojturi i tij të lirohet nga paraburgimi ose t`i caktohet ndonjë masë alternative më e butë, apo të njëjtën t`a kthej në rivendosje.

- mbrojtësja e të pandehurit F. C., avokate Ardiana Azemi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 185, KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t`a aprovoj në tersi si të bazuar kërkesën e mbrojtëses së të pandehurit të parashtruar kundër aktvendimeve të atakuara, të ndryshohen aktvendimet e atakuara ashtu që i mbrojturi i saj të lirohet nga paraburgimi ose t`i vazhdohet ndonjë masë alternative më e butë nga neni 171 i KPP-së.

- mbrojtësi i të pandehurit A. M., avokati Mentor Neziri, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale të KPP-së, që ka të bëjë me vazhdimin e masës së paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, t`a aprovoj në tersi si të bazuar kërkesën e mbrojtëses së të pandehurit të parashtruar kundër aktvendimeve të atakuara, të ndryshohen

aktvendimet e atakuara ashtu që i mbrojturi i tij të lirohet nga paraburgimi ose t'i caktohet ndonjë masë alternative më e butë nga neni 171 i KPP-së, si arresti shtëpiak.

- mbrojtësja e të pandehurit G. I., avokate Teuta Zhinipotoku, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale të KPP-së dhe shkeljes së Ligjit Penal, që ka të bëjë me vazhdimin e masës së paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'a aprovoj kërkesën si të bazuar, t'i anuloj aktvendimet e atakuara me kërkesë, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose mbrojturi i saj të lirohet nga paraburgimi dhe ti shqiptohet një nga masat alternative më të buta nga neni 171 i KPP-së, siç është dorëzania në shumë prej 5.000 deri në 10.000 euro.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.05/2024 e datës 04.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit të refuzohen si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabazuara.

-Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit A. P., thekson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë për vazhdimin e paraburgimit, i vërtetuar edhe me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë janë kundërthënëse me brendinë dhe me arsyet që konsiderojmë se janë zbatuar gabimisht, me ç'rast nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e paraqitura janë të paqarta dhe kontradiktore. Gjykatat e instancave më të ulta gabimisht kanë konstatuar se me gjetjen e të pandehurve në liri i njëjti mund të ik apo arratiset duke mos ofruar asnjë provë të vetme që të vërtetonte se i mbrojturi i tij në të kaluarën është fshehur, ka ikur apo ka penguar rrjedhën e procedurës penale. Pastaj nuk ekziston as mundësia e ndikimit në dëshmitar apo në të dëmtuarin e as në zhdukjen apo asgjësimin e provave të veprës penale, për aktin se nuk është e qartë se në cilët dëshmitar mund të ndikoj e as cilat prova mund t'i zhduk apo asgjësoj, gjithashtu theksohet në kërkesë se nuk ka rrezik as të përsëritjes së veprës penale nga i mbrojturi i tij duke marrë parasysh mungesën e elementeve që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe rrethanat tjera në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, rrethanat personale të tija, sjellja e më parshme e tij, bashkëpunimi me organet e drejtësisë etj.

-mbrojtësja e të pandehurit F. C., në kërkesën e saj thekson se Gjykata e Apelit të Kosovës me rastin e vazhdimin të paraburgimit, nuk ka bërë përshkrimin e provave që mbështesin dyshimin e bazuar se i mbrojturi i saj ka ndërmarr veprime përgatitore apo inkriminuese dhe nuk ka sqaruar se cilat janë rrethanat e veprimeve përgatitore që ka ndërmarr i njëjti për kryerjen e veprës penale të cilat i vihen në barrë. Tutje theksohet se me vazhdimin e paraburgimit ndaj të mbrojturit të saj nuk është plotësuar kushti i përgjithshëm siç është dyshimi i bazuar, e as kushtet e veçanta e në veçanti potencohet rreziku i përsëritjes së veprave penale duke mos marr parasysh nga gjykata fare karakteristikat personale të të pandehurit F., ku sipas rrëfimeve të babait të tij kem të bëjmë

me një person që vuan nga çrregullimet psikike, pasi që në vazhdimësi i njëjti është në terapi të metadonit, medikament për qetësim e që me shumë vështërsi e përballon paraburgimin, për çka ka nevojë për trajtim të detyrueshëm mjekësor në liri.

-mbrojtësi i të pandehurit A. M., në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se pavarësisht dyshimit të bazuar se i mbrojturi i tij ka kryer apo jo veprat penale që akuzohet, konsideron se gjykata me rastin e vazhdimit të paraburgimit pa ndonjë arsye të bazuar ka aplikuar masën më të rëndë të sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurë penale dhe zhvillimin e pa penguar të procedurës. Tutje theksohet në kërkesë se theksohet se në këtë çështje penale nuk kemi një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri A., ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, nga se nuk kemi asnjë deklaratë të palës së dëmtuar, të ndonjë dëshmitari, të bashkakuzuari, apo ndonjë provë materiale se i pandehuri A., të ketë marrë ndonjë veprim inkriminues si në aktakuzë.

-mbrojtësja e të pandehurit G. I., në kërkesën e saj thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me rastin e vazhdimit të paraburgimit nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme për bazat ligjore dhe ate as për dyshimin e bazuar si kusht i përgjithshëm, e as në kushtet e veçanta. Arsyetimi i gjykatës se ekziston rreziku i shmangies nga ndjekja penale përmes arratisjes apo fshehjes fare nuk qëndron nga se i mbrojturi i saj është shprehur i gatshëm që në çdo kohë dhe fazë të procedurës penale do t'iu përgjigjet ftesave të gjykatës dhe prokurorisë dhe se vazhdimi i paraburgimit, është masë e pa nevojshme dhe e tepërt. I mbrojturi i saj ka vendbanim në Kosovë në Rr."..." nr. ..., të cilën adresë e posedon gjykata dhe prokuroria. I mbrojturi i saj nuk paraqet kurrfarë rreziku të ndikimit në dëshmitar, në bashkëpandehur apo në të dëmtuar për faktin se faza e hetimeve ka përfunduar, është ngrit aktakuza dhe se nuk ka se si të ndikoj apo të prish-asgjësoj provat e veprës penale. Po ashtu theksohet se Gjykata e Apelit, me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk ka vlerësuar drejt pretendimet ankimore dhe se nuk janë specifikuar veprimet inkriminuese të secilit të pandehur veç e veç, por si tersi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësve të të pandehurve janë të pabazuara, ngase aktvendimet kundër të cilave janë parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet, pasi që siç rezulton nga shkresat e çështjes, gjykatat e instancave më të ulta kanë dhënë arsye të mjaftueshme mbi dyshimin e bazuar nga baza ligjore e nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1, i KPP, se të pandehurit A. P., F. C., A. M. dhe G. I., kanë kryer veprat penale për të cilën dyshohen dhe se ndaj tyre nga prokurori i çështjes është ngrit aktakuzë.

Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurve A. P., F. C., A. M. dhe G. I., nga dispozita ligjore e nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.1 të KPP, nga se ekzistojnë rrethana që tregojnë rrezikun se po të gjenden të pandehurit në liri, të njëjtit mund të shmangen apo t'i qasen arratisjes, për faktin e peshës së veprave penale për të cilat ngarkohen, e këtë lehtë mund ta bëjnë kur merret për bazë fakti se të njëjtit janë të moshës së re, e kjo e shton dyshimin e bazuar se të njëjtit mund të ikin apo të largohen nga vendi ashtu që të jenë të pa arritshëm për organet e ndjekjes, prandaj këto e shtojnë dyshimin e bazuar se të njëjtit mund të ikin apo të largohen nga Republika e Kosovës dhe përsëri mund të jenë të paarritshëm për organet e ndjekjes, kështu që masa e paraburgimit është e nevojshme me qëllim

të sigurimit të pranisë së tyre në procedurë penale, me qëllim të zhvillimit normal të procedurës penale.

Qëndron, baza ligjore e vazhdimit të paraburgimit edhe sipas bazë ligjore nga neni 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.2 të KPP, sepse ekzistojnë rrethana se nëse lejohen të pandehurit të mbrohen në liri, ka arsye për të besuar se do të asgjësojnë, fshehin, falsifikojnë provat e veprës penale, ose të pengonin rrjedhën normale të procedurës penale, duke ndikuar në dëshmitar, të dëmtuar apo edhe në bashkëpandehur të cilët kanë vepruar si grup kriminal. Gjithashtu me qëndrimin e të pandehurve në liri, të njëjtit mund të pranojnë urdhër nga A. K.-L. dhe V. B., përkundër se janë duke e vuajtur dënimin në Burgun D., megjithatë të njëjtit dyshohen t'iu kenë dhënë urdhëra për kryerjen e disa veprimeve të rënda, prandaj ekziston rreziku potencial që të pandehurit me gjendjen e tyre në liri lehtë do të pengojnë rrjedhën e procedurës penale.

Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurve edhe sipas dispozitës së nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke marrë parasysh pesën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale ashtu që të pandehurit dyshohet se kanë funksionuar si grup për të krye vepra të rënda penale e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme apo për përfitime tjera, ashtu që i pandehuri F. C. së bashku me D. R. me dt., 18.06.2022, ka marrë detyrë nga të pandehurit A. K. dhe V. B., që për motive të ulta përfshirë dhënien e dëshmisë në një procedurë penale, që ta privojnë nga jeta tani të dëmtuarin R. B., pronar i biznesit “R. H. S.”, ku edhe e kanë bërë sulmin e parë me dt. 19.06.2022 në orët e para të mëngjesit, ku të njëjtit i është sulmuar lokali me koktej molotov por që nuk kishte përfunduar siç ishte planifikuar, me që i kishte shkaktuar vetëm dëme të konsiderueshme materiale, tani me datë 22.06.2022, në orët e para të mëngjesit kanë ndërmarrë veprimin e sulmit me granatë dore tek lokali i të dëmtuarit në lagjen ..., në P., në atë mënyrë që granatën e dorës e ka siguruar i pandehuri F. C., dhe së bashku me të pandehurit G. I., dhe D. R., kanë shkuar tek lokali për ta sulmuar ku granatën e dorës e ka hedhur i pandehuri G. I., por që nuk ka pasur pasoja në njerëz, përveç dëmeve materiale në tri vetura, ndërsa roli i të pandehurit E. C., ka qenë që ta vërtetojë se si ka ndodhur sulmi, të bëjë video-incizim të vendit të ngjarjes dhe të njëjtin t'ia dërgojë të pandehurit A. K.-L., si dhe ta kryej pagesën për ekzekutorët e sulmit, ku pas hetimit dhe vëzhgimit nga ana e policisë të pandehurit arrestohen. Rrethana këto që tregojnë rrezikun e përsëritjes së veprave penale duke pasur parasysh këmbëngulësin e tyre duke vepruar disa herë dhe atë me datë 19, 21 dhe 22 qershor 2022 për realizimin e qëllimit të tyre.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç pretendohet në kërkesën e mbrojtjes, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative nga neni 171 i KPP, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2022:127496
Datë: 15.01.2024
Numri i dokumentit: 05190741

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.05/24, më datë 09.01.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,
Rasim Rasimi